

INSTRUMENTI EUROPIAN I FINANCIMIT

COSME

Programi i BE-së për Konkureshmerine e

Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla

www.akti.gov.al



akti

Agjencia e Kërkimit
Teknologjisë dhe Inovacionit

1. Cfarë është Programi COSME



COSME Programi i BE-së për Konkureshmerine e Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla që **do të zgjasë nga 2014 - 2020** me një buxhet të planifikuar prej **2.3 miliardë EUR**, është një program i hartuar specifikisht për të mbështetur NMV-të.

Duke qenë NVM-të shtylla kurrizore e ekonomisë europiane dhe duke siguruar 85% të vendeve të reja të punës, Komisioni Evropian ka për qëllim promovimin e sipërmarrjes dhe përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm të biznesit për NMV-të për ti lejuar ato të realizojnë potencialin e tyre të plotë në ekonominë e sotme globale.

Cosme menaxhohet në emër të Komisionit Evropian nga Agjencia Ekzekutive për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla. **(EASME)**

Cosme lehtëson dhe mbështet aksesin e NMV-ve në financime nëpërmjet dy instrumenteve financiare:

- **Instrumenti I Garantimit të Kredisë.**
[http://www.eif.org/what we do/guarantees/single eu debt instrument/cosme-loan-facility-growth/index.htm](http://www.eif.org/what_we_do/guarantees/single_eu_debt_instrument/cosme-loan-facility-growth/index.htm)
- **Instrumenti për rritjen.**
http://www.eif.org/what we do/equity/single eu equity instrument/cosme_efg/index.htm

2. Kush mund të aplikojë?

Thirrjet janë të hapura për NMV-të dhe Persona Juridik të tjerë. NMV-të mund të marrin pjesë individualisht ose në konsorciume. Konsorciumet duhet detyrimisht të kenë lead-partner një NMV. NMV-të duhet të



plotësojnë kushtet e Rekomandimit 2003/361/EC të Komisionit Europian mbi përkufizimin e NMV-ve. (Njësoj si tek H2020)



3. A është kusht për aplikim partneriteti me studiues , universitete apo institucione kërkimore jashtë Shqipërisë?

Nuk përbën kusht, por vlerë të shtuar në drejtim të procesit të përzgjedhjes së projekt-propozimit.

4. A nevojitet bashkëfinancim nga aplikanti qoftë ky individ apo institucion ?

Bashkëfinancimi nga aplikanti duhet të jetë 50% të kostove të pranueshme.

5. Sa është min dhe max i shumës së grantit që ofrohet për aplikantin ?

Kontributi i BE mund të shkojë 800.000 EUR deri 1.000.000 EUR për projekt, ose 50% të kostove të pranueshme.

6. Sa është kohëzgjatja mesatare e një projekti ?

Një projekt mund të zgjasë nga 12 – 33 muaj.

7. Ku mund të gjenden thirrjet për aplikim ?

Thirrjet mund të gjenden në Portalin e Pjesëmarresit, në seksionin dedikuar Programit COSME.

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/opportunities/cosme/index.html#c.calls=CallIdentifier.Status/t/FORTHCOMING/1/1/0&CallIdentifier.Status/t/OPEN/1/1/0&CallIdentifier.Status/t/CLOSED/0/1/0&+PlannedOpeningDate/asc>

8. Cilat janë hapat për një aplikant që aplikon për herë të parë ?

Aplikimet bëhen nëpërmjet portalit [Participant Portal](#), ku gjenden temat dhe thirrjet përkatëse të Programit.

Hapi i Parë është regjistrimi në portal.

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/organisations/register.html>

Procedura është e njëjtë me programin Horizon2020.

Projekt-propozimet duhet të dërgohen elektronikisht nëpërmjet Shërbimit të Dërgimit (Submission Service), i cili aksesohet online në Faqen Zyrtare të Thirrjeve, pasi zgjidhet Tema e Thirrjes dhe Tipi i Aksionit përkatës.

.Udhëzime të detajuara mbi dërgimin e projekt-propozimeve gjenden në Manualin Online të Horizon2020:

http://ec.europa.eu/research/participants/docs/h2020-funding-guide/grants/applying-for-funding/submit-proposals_en.htm

Thirrjet e COSME:

Kushtet kuadër për sipërmarrjet

- [COS-DESIGN-2015-3-03: Design-based consumer goods](#)
Afati: **23 July 2015** 17:00 (Brussels time)

Turizëm

- [COS-TOUR-2015-3-04: Supporting Competitive and Sustainable Growth in the Tourism Sector](#)
Afati: **30 June 2015** at 17:00 (Brussels time)

